



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje me qira makineri për shtrimin me asfalt të rrugëve urbane të Bashkisë Divjakë për vitin 2024”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): (CPV): 43312300-6 Makineri asfaltimi, (CPV): 43312000-3 Makineri shtruese rrugësh, (CPV): 43312400-7 Rule rrugësh.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 916 667 (dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh, nga e cila: 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh nga Granti dhe 1 666 667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Divjakë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar dhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, si edhe në nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021, 2022 dhe 2023 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM Nr.285/2021 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në piken 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference eshte bere që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, ne nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma c, të Nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP, i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Rrul me kompresor	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Autobitumatrice	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera

1 (një) Rrul me kompresor i cili do të realizojë ngjeshjen e asfaltit të shtruar në rrugë.

1 (një) Autobitumatrice e cila do të përdoret për spërkatjen me primer të rrugëve para hedhjes

së asfaltit.

1 (një) Asfaltoshtruese e cila do të përdoret për shtrimin me asfalt të rrugëve urbane në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Divjakë.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e meposhtëm:

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje qarkullimi, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, foto perkatëse.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, foto perkatëse.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dokumente të vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij dhe foto perkatëse.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publike, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.

Kosto e transportit duhet të financohet tërësisht nga operatori ekonomik brenda çmimit të kontratës.

Për difekte të ndodhura në mjet gjatë punës, operatori ekonomik do të marrë përsipër riparimin e tyre me shpenzimet e veta.

Nëse procedura e riparimit të difektit do të zgjasë më tepër se një ditë, periudha e difektit do të shtohet në zgjatjen e afatit të përdorimit të mjetit me qira.

Mjetet, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 41, pika 4, germa ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet e kërkuara janë vendosur në proporcion me volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Numri dhe lloji i makinerive në pronesi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të mjeteve, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Mjetet e mësipërme, janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Automjetet nevojiten për realizimin e shërbimeve të nevojshme sipas funksionit perkates që ka secili mjet.

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë:

- Manovrator 3 (tre)

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin nr.200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin nr.200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.....
.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT